

DEPARTAMENTI I FIZIKËS NDËR VITE

BEJO DUKA., POLIKRON DHOQINA.

Fillesa e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, si edhe fakulteteve të tjera të krijuara në fillim të viteve 50' ishte Institutit i Lartë Pedagogjik (Dhjetor 1946), që u inkluaduan në Universitetin e Tiranës, themeluar në vitin 1957. Në këto vite të fillimit, dega e Fizikës kishte një katedër dhe pak laboratore në cepin e djathtë të katit të parë të godinës A të këtij fakulteti, të ngritur me përkushtimin e themeluesit të kësaj dege (Prof. Sotir Kuneshka) dhe pasuesve të tij si Flamur Zela, Skënder Koja, Fatmir Sinoimeri (të shkolluar këta në Rusi dhe Poloni), Niko Thomo, Kleanthi Qendro, Pavllo Pilika, Nuçi Panidha, Lulëzime Aliko, Dritan Spahiu, Petrit Skendi, Servet Dani, etj. Me ndërtimin e godinës B (më 1967), dega e Fizikës u spostua në dy katet e sipërme të kësaj godine ku vijon edhe sot Departamenti i Fizikës.

Do ta ndanim historinë e departamentit në disa periudha me ritme zhvillimi të ndryshme, ku këto ritme më së shumti janë ndikuar nga vëmendja dhe qëndrimet e autoriteteve më të larta shtetërore ndaj shkencës dhe arsimit të lartë, si edhe nga ngjarje të rëndësishme shoqërore.

Në periudhën 1957-1965 pati një rritje të pakët numerike dhe kualifikime të stafit pedagogjik, kryesisht në mësimdhënien e fizikës së përgjithëshme si edhe të disiplinave që ngriheshin mbi fizikën e përgjithëshme. Pati edhe një zgjerim të laboratoreve të fizikës me ndihmën vendeve të lindjes. Në vitet e para të kësaj periudhe një impuls të madh dha prania e pedagogëve të kualifikuar rusë dhe e një fluksi të madh literature në rusisht, nga e cila kanë përfituar shumë breza fizikanësh që mësuan rusisht edhe në shkollën e lartë. U hodhën edhe bazat e kërkimit shkencor të thjeshtë si radioaktiviteti natyror i ujrave, studime meteorologjike, zbatime të ultatingujve, etj. Në këtë periudhë autoritetet e regjimit komunist ishin të interesuar për zhvillimin kualitativ të arsimit të lartë në shkencat ekzakte si Matematika, Fizika etj., duke arritur deri atje sa të autorizonin pedagogët e këtyre degëve që të selektonin nxënësit në të mirë të shkollave të mesme për ti regjistruar në këto degë.

Në periudhën 1965 – 1972, ashtu si arsimi në përgjithësi edhe arsimi i lartë u ndikua nga lëvizja e masivizimit të tij, për pasojë pati një dy-tre fishim të drejtave të studimit edhe në degën e Fizikës, që sigurisht krahas studentëve shumë të aftë pati edhe prurje të dobta. Pikërisht më 1965 pati edhe një riorganizim të degës së Fizikës. U vendos që dega e studimeve në fizikë, pas dy vitesh studimesh të përbashkëta, të ndahej në Fizikë 4 vjeçare që me dy vite të tjera studimesh të diplomoheshin si mësues fizike dhe dega 5-vjeçare që me tre vite të tjera studimesh do të diplomoheshin si Fizikanë. Njëkohësisht, edhe

katedra e Fizikës u nda më dysh: “Katedra e Fizikës së specialitetit” dhe “Katedra e Fizikës së Përgjithëshme”, stafi i të cilës në atë kohë jepte fizikë të përgjithëshme në të gjithë degët e tjera të FSHN ose në fakultete të tjera, përveç degës së Fizikës, ku lënda e fizikës së përgjithëshme dhe lëndët e tjera të specialitetit të kësaj dege mbuloheshin nga stafi i Katedrës së specialitetit, që drejtohej nga Prof. Kuneshka, ndërkohë që katedra e Fizikës së përgjithëshme drejtohej nga Prof. Skënder Koja. Në këtë periudhë, u konsoliduan programet mësimore të të dy profileve. Duke përfituar nga mardhëniet shumë të mira me Kinën, pati një hov të madh kualifikimi i një pjesë të konsiderueshme të stafit, që shërbeu si bërthama e ish Institutit Bërthamor, i pajisur me ndihmën e qeverisë kineze dhe inauguruar më 1972. Ky institut, që kaloi në administrim të Akademisë së Shkencave, ka shërbyer për shumë vite, si një laborator kërkimor, ku u instaluan një sërë teknikash dhe metodika analizash në shërbim të mjekësisë, bujqësisë, industrisë, por shërbeu edhe si një bazë logjistike për punën kërkimore të shumë pedagogëve të FSHN. Një dhuratë tjetër e qeverisë kineze, ka qenë edhe Mikroskopi elektronik (1972), i instaluar në cepin e godinës C, i cili së bashku me pajisje të tjera moderne të asaj kohe shërbeu si një bazë e mirë logjistike për një sërë analizash të materialeve të ndryshme.

Periudha 1972-1976, pati një zbehje të interesimit të udhëheqjes komuniste ndaj probemeve të arsimit të lartë, dhe zhvillimi i departamentit gjatë kësaj periudhe konsistoi në një zgjerim numerik të tij për shkak të rritjes së ngarkesës mësimore. Në mënyrë të veçantë në këtë periudhë do të konsideronim si arritje të madhe hovin që mori metodika e mësimdhënies së fizikës dhe popullarizimi i saj nëpërmjet emisioneve televizive, falë punës pasionante të pedagogëve si Kostandin Leka dhe laborantëve si Besnik Latifi e Meri Pançi. Në këtë periudhë filloi edhe botimi i një sërë dispensash mësimore të hartuara në shqip nga pedagogët e departamentit që shërbyen për disa breza studentësh.

Në periudhën 1976-1987, pati përsëri një rritje të vëmendjes së udhëheqjes komuniste ndaj arsimit të lartë dhe në veçanti ndaj kërkimit shkencor, por që ky kërkim shkencor të orientohej në mënyrë që të ndihmonte realizimin e motos “të prodhojmë gjithçka me forcat tona”, në kushtet e një izolimi nga e gjithë bota. U gjet edhe mekanizmi i nxitjes së këtij kërkimi, që ishte fitimi i gradave shkencore si “Kandidat i Shkencave” ose i titujve si “Docent”. Ishte si një lloj fushate ku u përfshi thujtë e gjithë stafi i të dy katedrave dhe si pasojë pati edhe arritje, përmendim këtu arritjet në fushën e studimit të materjaleve të ndryshme në disertacionet e pedagogëve, si Ilia Prifti, Fatos Klosi, Afërdita Veveçka, Meri Treska, etj, arritjet në studimin e Elektrizimit statik dhe zbatimeve në industri (Floran Vila dhe Pëllumb Berberi), në studimin e fushave elektrike e magnetike natyrore, etj. Po në këtë periudhë, pati kualifikime afatmesme apo afatgjata jashtë shtetit, kryesisht në Francë. Ndonëse të pakta ato rezultuan të suksesshme si psh ato të Rexhep Meidani, Raimond Sharko, Marenglen Spiro, Kastriot

Islami, etj. Po në këtë periudhë, labororet e Fizikës u përmirësuan më laboratore moderë prodhim gjerman PHYWE falë një financimi të madh shtetëror.

Një ndikim të madh negativ në gjithë arsimin e lartë, e në veçanti në degën e Fizikës, pati fushata e ashtuquajtur e “qarkullimit të kuadrove” e iniciuar nga udhëheqja komuniste, që u zbatua keqazi edhe për pedagogët e Universitetit. Në këtë periudhë, me vendime partiake, u larguan për vite të tëra nga të dy katedrat e Fizikës jo vetëm pedagogë të vjetër e me kualifikim të lartë, si F. Sinoimeri, D. Spahiu, N. Panidha. por edhe pedagogë më të rinj si Z. Mulaj, E. Hysenbegasi, Th. Karaja. Këto largime dëmtuan shumë degën e Fizikës, jo vetëm në aspektin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor por më së shumti në aspektin moral e psikologjik të stafit akademik.

Në periudhën 1987-1990, ndonse nuk pati vemendjen e duhur nga ana e autoriteteve qeveritare, drejtuesit e fakultetit dhe universitetit, bazuar në prurjet e reja në departamentin i Fizikës, ja arritën të riorganizonin degën e Fizikës (1987) në 4 katedra: Fizika e Përgjithëshme (e drejtuar nga F. Vila dhe Z. Mulaj), Fizika Teorike (e drejtuar nga R. Meidani dhe H. Sykja), Fizika e trupit të ngurtë (e drejtuar nga R. Sharko dhe I. Prifti) dhe Biofizika (e drejtuar nga E. Hysenbegasi e M. Spiro). Krahas këtij riorganizimi u arrit edhe përmirësimi i planeve mësimore. Kërkimi shkencor vijoi për inerci në vazhden e kërkimeve shkencore të mëparshme në fushën e trupit të ngurtë, fizikën e materjaleve, elektostatikë, biofizikë, gjeofizikë, etj. Në këtë periudhë u realizua edhe zëvendësimi i metodistëve të shquar të Fizikës si Kleanthi Qendro, me pedagogë të rinj. Prurjet e reja në përgjithësi kanë qënë të arrira, pasi edhe kontigjenti i studentëve që vinin në këtë degë vijoi që të ishte shumë i mirë deri nga viti 1992. Ndonëse në kushtet e rregjimit totalitar, ku pedagogët nuk arrinin dot të kishin komunikime, pjesëmarrje në konferenca apo botime jashtë vendit, pati një vijueshmëri kërkimi dhe botimesh brenda vendit.

Si edhe për të gjithë shoqërinë, periudha më e vështirë dhe me ndryshimet më të mëdha edhe për departamentin e Fizikës kanë qënë vitet 1990 – 2000 (në drejtimin e Prof. R. Meidani dhe Prof. H. Sykja). Vështirësia kryesore lindi prej largimit të një pjesë të stafit më të kualifikuar, por edhe prej rënies së interesit të studentëve për Fizikën. Ngjarja më rëndësishme që ndikoi në dobësimin e departamentit ishte shpëputja e një pjese të rëndësishme të stafit akademik, për shkak të kalimit të tyre në Universitetin Politeknik që u shpëput krejtësisht nga UT më 1991. Por nga ana tjetër, rrëzimi i regjimit diktatorial, hapi persepektiva të reja zhvillimi edhe për Departamentin e Fizikës. Në këtë periudhë pati hov kualifikimesh të stafit akademik që nuk u largua, kualifikime nëpërmjet bursave që siguroheshin ose personalisht ose me ndihmën e programit Tempus. Kjo u dha mundësi atyre që të krijonin kontakte, të merrnin pjesë në konferenca si dhe të arrinin të botonin me bashkautorë të huaj madje edhe në revista shkencore të

rëndësishme me faktor impakti, si psh Condensed Matter Physics, Physica Status Solidi, Il Nuovo Cimento, Journal of Electrostatics, Geophysical Journal International, Astronomy and Astrophysics.

Një arritje logjistike e kësaj periudhe, ishte ngritja e laboratorit të Fizikës Logaritëse, ku u instalua një Workstation (1991) me disa terminale dhe u fut si lëndë e re në mësimdhënin e lëndës “Fizika Llogaritës”, për herë të parë i realizua dhe lidhja në rjet e këtij laboratorit me Laboratorin e Informatikës (kati II i godinës B). Po në këtë periudhë u ndryshuan planet mësimore, duke e shtrirë lëndët e përbashkëta për të dy profilet nga viti I deri në vitin e III, mandej profili mësuës vijonte 1 vit dhe profili Fizikan vijonte 2 vite. Edhe organizimi i Departamentit u riformua në 5 seksione, që tashmë quhen grupe mësimore: Fizika e Përgjithëshme, Fizika e Materialeve, Fizika teorike, Fizika Llogaritëse, Fizika biomjekësore. Në këtë periudhë disa pedagogë nga stafi më i vjetër i departamentit fituan titujt Profesor dhe As/Profesor. Ndonëse në kushte të vështira, departamenti në këtë periudhë ka arritur të punësonte studentët më të mirë, duke i zëvendësuar ata vazhdimisht, pasi largoheshin për doktoreture jashtë. Ata kanë demonstruar formim shumë të mirë në departamentin tonë dhe kanë arritur suksese të mëdha edhe jashtë, si psh Oronc Çiftja, Laura Mersini, Erjon Gjonaj, etj.

Periudha 2001 – 2007, që përkon me futjen e sistemit të zgjedhjeve në Universitet, mund të themi si ishte periudha e ndaljes së largimeve të stafit akademik dhe stabilizimit të tij, madje në fund të kësaj periudhe pati edhe 2 rikthime të rëndësishme në departament (pasi u doktoruan në perëndim: M. Ifti dhe A. Boriçi). Një arritje e kësaj periudhe është fitimi i një projekti European JEP (Join European Project) TEMPUS (Kordinator B. Duka, Departamenti i Fizikës, 2002-2003): “Reformimi i kurrikulave të studimeve në Fizikë” me konsorcium prej 2 Institucionesh vendase: Universiteti i Tiranës (Departamenti i Fizikës, kordinator), Instituti i Fizikës Bërthamore (partner) dhe tre institucionesh të huaja: Universiteti Ferrarës (Itali, kontraktor Carlo Ferrario, Departamenti i Fizikës), Universiteti i Siegen-it (Gjermani, Fakulteti i Fizikës, partner) dhe Universiteti i Lecces (Itali, Departamenti i Fizikës, partner). Nga ky projekt departamenti ynë përfitoi 10 mobilitete kualifikimi (1 deri 3 mujor) të stafit akademik dhe 2 mobilitete kualifikimi të personelit ndihmës, si edhe 2 labore të mësimore-kërkimore: laboratorin e Elektronikës dhe laboratorin e Mjedisit. Në kuadër të këtij projekti, u projektua plani i studimeve në Fizikë me dy cikle: Cikli I Bachelor dhe Cikli i II Master me tre orientime të ndryshme: Fizikë e Materialeve, Biofizikë dhe Fizikë Mjekësore, Fizikë Teorike dhe Llogaritëse.

Një prurje e rëndësishme logjistike në fund të kësaj periudhe ishte edhe realizimi i një projekti bilateral me Univesitetin e Selanikut (Greqi), nëpërmjet të cilit u

instalua një laborator kompjuterash (20 copë), një klaster CPU-sh, etj. (dhuratë e qeverisë Greke).

Në fund të kësaj periudhe, kur drejtimin në departament e mori Prof. Mimoza Hafizi, u arrit ristrukturimi i studimeve, kryesisht sipas parashikimit të projektit TEMPUS, por tashmë pas ciklit të I (Bachelor) cikli i II ndahej në dy Mastera: Master Shkencor në Fizikë dhe Master shkencor mësues AML (2 vite) dhe u përpiluan planet e mësimore të këtyre cikleve, të cilat me pak ndryshime vazhdojnë edhe sot.

Periudha 2008 – e në vijim, ndonëse karakterizohet përsëri nga prurje studentore të dobëta në departament, ka patur edhe studentë të shkëlqyer që janë stimuluar ose mbajtur si asistentë në departament. Kjo periudhë përkon me një fushatë të dytë të nxitjes së kërkimit shkencor, është pikërisht çelja e ciklit të III të studimeve (doktoraturës), ku u përfshinë shumë studentë që kishin mbaruar Masterin Shkencor në departamentine e Fizikës (FSHN) ose në fakultete të tjera. Theksojmë këtu, që në dallim nga departamentet apo fakultetet e tjera, departamenti i Fizikës ka qënë pak më i rezervuar në kuotat dhe pranimet e doktoratave, por edhe në këtë departament cilësia nuk ka qënë gjithnjë në nivelin e duhur. Kjo jo vetëm për shkak të cilësisë së kandidatëve, por edhe për shkak të mungesave të laboratorëve kërkimorë në fizikë, ose edhe për shkak të mangësisë së një udhëheqjeje efektive. Doktoraturat e mbrojtura deri tashmë, si dhe ato në vijim, janë në fusha shumë të larmishme, si nga fushat teoriko-llogaritëse: simulime nga Kromodinamika Kuantike në Rjetë, simulime dhe modelime statistikore të sistemeve komplekse, analiza të Gama-shpërthimeve dhe lenteve gravitacionale në astrofizikë, modelime/simulime të variacioneve të fushës gjeomagnetike, etj. ashtu edhe nga fushat aplikative: metoda analizash të ndryshme të materialeve të ndryshme inertë ose biologjikë, metodika dhe prognoza mbi rrezatimet e aplikuara në spitalet tona, metodika të ndryshme të analizave mjedisore në ujra dhe në ajër, etj

Në këtë periudhë, departamenti ynë është drejtuar rradhazi nga Prof. Mimoza Hafizi, Prof. Theodhor Karaja dhe tashmë nga As. Prof. Polikron Dhoqina. Në përgjithësi, drejtimi i departamentit ka qënë normal, me vendime kolegjinale, dhe pa konflikte.

Duke parë vështirësitë që po ndesh departamenti i Fizikës për regjistrimet e studentëve në ciklin e parë dhe sidomos në ciklin Master Shkencor në Fizikë, ku me vështirësi arrihet kontigjenti minimal, ka ardhur koha që stafi i departamentit në bashkëpunim me departamentet e tjera të FSHN si dhe me institucione të tjera, të bëjë analiza serioze që të çojnë në një reformim të planeve e programeve mësimore, si dhe në bashkëpunim me organet drejtuese të UT të hartojë një plan zhvillimi prespektiv për kërkimin shkencor, që duhet të burojë nga një plan zhvillimi kombëtar.